



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr. 515/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Vushtrri, Hajrullah Rama, nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Vushtrri, paraqitur për shkak të keqpërdorimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa: ZLA.nr 515/2017 e datës 25.10.2017 e parashtruar nga Hajrullah Rama, kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Vushtrri, nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Vushtrri, paraqitur për shkak të keqpërdorimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 25.10.2014, nga Hajrullah Rama, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Vushtrri, nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Vushtrri, në të cilën pretendon se i janë manipuluar votat nga ana e komisionarëve në vendvotimet e këtyre fshatrave: në Dubovc, vv: 2702b, 2702x, 2703b, në Nadakofc, vv: 2708b, në Druar, vv: 2706B, në Novolan, vv: 2709b, në Stanovc i Epërm, vv: 2710b, në Smrekonic, vv: 2713b, 2704b, në Strofc, vv: 2717b, në Mihaliq, në vv: 2720b, në Shtitaricë, në vv: 2727b, në Bukosh, vv: 2730b, dhe në vv: 2701b.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë përkitazi me manipulimin e votave në Komunën e Vushtrrisë, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me

rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi për shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankuesit Hajrullah Rama, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL Anr. 515/2017 me datën 25.10.2017



Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.